



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS

Njoftim Paraprak Përqendrimi

Rasti: Përftimi i kontrollit nga Messer Group GmbH dhe Yeti Investments S.a.r.l mbi disa asete të Linde Aktiengesellschaft dhe Praxair Inc nëpërmjet MG Industries GmbH

Me shkresën Nr. 443 Prot., datë 20.07.2018 të Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar përqendrimi midis për përfitim të kontrollit të përbashkët mbi shoqërinë target nga ana e Messer Group GmbH dhe Yeti Investments S.a.r.l.

Palët pjesëmarrëse në transaksion :

MG Industries GmbH, një shoqëri private me përgjegjësi të kufizuar, e organizuar sipas ligjeve të Republikës Federale të Gjermanisë.

Messer Group GmbH, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, është një prodhues global dhe distributor i gazrave industrialë, farmaceutikë dhe të specializuar. Messer prodhon dhe furnizon oksigjen, nitrogen, argon, dioksid karboni, hidrogjen, helium, gazra për saldime inerte, gazra të specializuar, gazra për përdorim mjekësor dhe një variacion të madh miksime gazrash. Produktet e Messer kanë zbatim të gjerë në industrinë e çelikut dhe metalit, industrinë kimike, sektorët ushqimorë dhe farmaceutikë, industrinë e automjeteve dhe elektronike, kërkim dhe në energjitë e mbrojtjes së mjedisit.

Yeti Investments S.a.r.l, është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, me seli në Luksemburg, është themeluar më 11.06.2018 me objekt marrjen e interesave në një formë të çfarëdoshme në shoqëritë e Luksemburgut dhe të huaja, përfitimi me blerje, regjistrimi apo çdo mënyrë tjetër si dhe transferimi me shitje, këmbim apo tjetër, të aksioneve, bonove, obligacioneve etj.

Linde Aktiengesellschaft (Shitësi 1), shoqëri aksionare, shoqëri e organizuar sipas ligjeve të Republikës së Gjermanisë (Linde) dhe **Praxair Inc (Shitësi 2)** korporatë e organizuar sipas ligjeve të Delaware, SHBA (Praxair)

Praxair: Furnizimi i gazrave industrialë, gazrave mjekësorë, gazrave të specializuar dhe shërbimeve të lidhura, gjithashtu dhe teknologjike e trajtimeve të sipërfaqeve

Linde: Prodhimi dhe shitja, furnizimi i garzave industrialë, gazrave mjekësorë, gazrave të specializuar dhe shërbimeve të lidhura, duke përfshirë inxhinierinë.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me neni 10, pika 1 dhe neni 12, pika 1, germa a dhe pika 2, të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros në tregun e brendshëm. Për këtë arsye ky transaksion i është nënshkruar

procedurës së njoftimit të përqendrimit duke plotësuar Formularin e Thjeshtuar të Njoftimit të Përqendrimit.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.